

Nr 85 Prot

30.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHITETËRORE

Nr. 22603/Prot.
5

Tiranë, më 27.3.2023

VENDIM I ASAMBLEËSË SË AKSIONARIT

Nr 21/1 Datë 27.3.23
PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË “PRODHIM MOBILJE” SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Prodhim Mobilje” sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Prishjen e shoqërisë “ Prodhim Mobilje” sha Tiranë dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Znj. Alisa Prela.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
4. Znj.Aida Maloku, Auditues Ligjor të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet Likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ



Nr 84 Prot
Dt 30.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 22603/4 Prot.

Tiranë, më 27.3.2023

VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr 21 Datë 27 3 2023

PËR

LIRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë, për shkak të situatës së rënduar financiare, mungesës së objektit të veprimtarisë, ngarkesës me detyrime, mos çregjistrimit në tatime të shoqërive të përthithura dhe dy ndërmarrjeve shtetërore ish-Kombinati i Tekstileve të Pambukta dhe Uzina Mekanike e Tekstilit;

VENDOSA:

1. Lirimin e Z. Arben Seferi nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha Tiranë.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar "Për regjistrimin e biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Delina IBRAHIMAJ